

MATERIAL LEKSIKOR NGA KRAHINAT

Në këtë artikull po botojmë materiale leksikore e frazeologjike nga krahinat, të mbledhura nga bashkëpunëtorët e jashtëm të Institutit të historisë e të gjuhësisë M. Muho, U. Çina e M. Ekonomi. Këto materiale janë redaktuar përkatësisht nga K. Sima, J. Thomaj e M. Samara.

MUSA MUHO

Material leksikor i mbledhur në krahinën e Vlorës

barkmbúshur-i *m. sh.* -, -it; i ngopuri, i pasuri. *Barkmbushuri* s'i beson barkdërrasës. (I pasuri s'i beson të varfërit).

barkdërrásë-a, *f. sh.* -a,- at; njeri që s'ka ta mbushë barkun me bukë. *Barkmbushuri* s'i beson *barkdërrasës* (I pasuri nuk i beson të varfërit).

bisbíq *mb.*; i zgjuar, i shkathët shumë. Sa *bisbiq* që është ai djalë!

brosh-i *m. sh.* -e, -et; varëse gryke me gurë të çmuar (ose falso por të shkëlqyer). Ajo vajzë kishte në grykë një *brosh* shumë të bukur!

buzëpagëzúar *mb.*; që s'ka parë kurrë të mirë në jetë. Vajzë *buzëpagëzuar* si atë s'më ka zënë syri!

bullubrëshkë-a *f. sh.* -a, -at. Grua e shëmtuar po e veshur mirë dhe e stolitur jashtë mase. Ik, moj *bullubreshkë* tutje, se ç'ç' të duket vetja!

branísje-ja *f. sh.* -e, -et; vuajtje e madhe, torturë shpirtërore. Është bërë ashtu siç e sheh më shumë nga *branisja* e të birit se sa nga mosha dhe pleqëria.

barkdënc-e *mb.*; barkmadh. Ik, more, *barkdënc*.

bythëtúrtull *mb.*; që s'i rri bytha në një vend, po lëvis shumë. Ik more *bythëturtull*, ti s'duron dot as pesë minuta në një vend.

barkskufullósur *mb.*; që ka ndonjë sëmundje në bark. Ajo është *barkskufullosur*, vuan shumë e s'kanë ç'i bëjnë doktorët.

çýst *mb.*; shumë i mirë, më i mirë se të gjithë, i zgjuar. Djali yt u shqua për të mirë, ua shkoi shokëve, dolli *çyst!*

ckëlíqe-ja *f. sh.* -e, -et; lënda si dyllë që del në mëngjez në anë të syve sidomos kur i kemi të sëmurë. Sepse më kanë zënë sytë *ckëliqe*. Përdoret edhe *ckëlë-a*.

ckulíth *ndf.*; mbledhur grusht, skrupull. Ish mbështjellë e bërë *ckulith*.

cálle-ja *f. sh.* -e, -et; kokërr fiku e pabërë, e papjekur. Pse i këpute këto *calle*, apo do t'jua hedhësh dhënve?

cërre-ja *f. sh.* -e, -et; pikë, çikë, grimë. S'kemi asnjë *cërre* vaj sonte!

dhëmbërruazë *mb.*; që i ka dhëmbët të rregullt, të bukur e të bardhë si rruaza. Kur qeshte ajo grua *dhëmbërruazë*, të kënaqte shpirtin.

engjëllón *pav.*; zbardhëllen drita. Aq shpejt jam zgjuar sa s'kish *engjëlluar* akoma.

engjëll-i *m. vet. nj.*; të zbardhëllyerit e dritës pa gdhirë akoma mirë dita; agim. U zgjova që me *engjëll*. Nesër ngreu me *engjëll* që të nisemi shpejt e t'arrijmë me fresk.

heqkéq-e *mb.*; që ka vuajtur në jetë, që ka hequr keq. Ai është një burrë *heqkeq*, e njeh mirë jetën se ka vuajtur shumë vetë.

hastërë-a *f. sh.* -a, -at; rënje e stomakut. Më ka vrrarë *hastera* ore të keqen nëna, mbase di ndonjë që e ngre?

hundëlësh-i *m.*; përdoret për ndonjë njeri që nuk është rrahur dhe shtruar në dru poshtë nga të tjerët; vetëm atëhere ai që është i mundur i a sheh hundën me lesh nga poshtë tjetrit, që e ka mundur. Talle ti, s'ke parë *hundëlesh* ndonjëherë, prandaj bën kështu!

hundëpërpjetë *mb.*; përdoret në mënyrë figurative për njerëzit që janë mendjemëdhenj, që u pëlqen vetja. Ama ç'*hundëpërpjetë* që është ai!

fickurr-i *m. sh.* -j; të hequrit bark shumë hollë që i zë zakonisht fëmijët. E griu *fickurri*, e lau, s'ka derman, del 20 herë në ditë.

fishkash *mb. dhe em.* -i, *m. sh.* -ë, -ët; ai që e ka trupin, mishin si të fishkur nga mosha, mundimet, hallet ose nga shëndeti i lig. Ti *fishkash* do të mundesh me mua?

fëndék-e *mb.*; që ka frikë. Ai është djalë *fëndek*, ka frikë dhe nga hija e tij.

flokáte-ja *f. sh.* -e, -et; velenxë me flokë. Hidhma pak *flokaten* se po mbërdhi.

fúfë-a *f. sh.* -at; 1) gur i madh që mezi merret në duar. Rri urtë se po rrëmbej atë *fufë* e po ta thyej kokën! 2) përdoret edhe për fiqtë që nuk janë pjekur akoma. Qënkan *fufa* këta fiq.

faqenxírë *mb.*; që ka bërë ndonjë turp, që ka nxirë faqen, turpmadhe. Ajo vodhi e u bë *faqenxirë*.

gojëqépur *mb.*; i heshtur, që nuk ta kthen fjalën; i urtë, i sjellshëm. I vogli përpara prindërve duhet të jetë *gojëqepur* e këmbëlepur.

gërdís *kal.* -a, -ur; 1) shemb në dru, ngop, rrah shumë. E rraha dhe e *gërdisa* në dru. 2. përdoret edhe në kuptimin u ngopa së ngrëni. Hëngra e u *gërdisa*.

kúrvull *mb.*; që është goditur nga paraliza, që ka mbetur ulok. Atë e ka bërë sëmundja *kurvull*, është mbledhur sa një grusht.

konupjere-ja *f. sh.*, -e, -ët; rrjetë e hollë që hidhnin përpara mbi krevat kur flinin, në mënyrë që të mbroheshin nga mushkonjat. Pa *konupjere* më përpara në Vlorë nuk flije dot.

kriskë-a *f. sh.* -a, -at; lopatë e vogël prej hekuri në formë trekëndëshi

me bisht të hollë, që shërben për të ruajtur magjen e bukës nga brumi që i ngjitet.

kthij kal. -va, -rë; ndaj shqerrat, kecërit nga t'ëmat që të mos i pijnë, kur duam t'i mjelim ato; këput. Tashti u rritën pak kecërit, prandaj natën *kthiji* e ditën lëshoi me t'ëmat!

kuckunkëputur mb.; që nuk ka pranë tij ndonjë njeri të afërt; njeri pa njeri. Ai është *kuckunkëputur*, s'i del njeri për zot.

kërcizambák-e mb.; që i kanë duart ose këmbët të gjata e të bukura; Ama ç'*kërcizambake* që qenka ajo grua!

kacërrí-a f. sh. -të; trimëri, burrëri. Na shet *kacërri*, të duket vetja sikur ta ka njeri frikën!

krahósem vet.; bashkohem, afrohem me një bari tjetër në mënyrë që të ndihmojmë njëri-tjetrin kur kemi nevojë. Me kë je *krahosur* sivjet, o Mehmet? — Me Ganinë.

kqýrës-i m. sh. -a, -at; *vjet.* Inspektori i arësimit p.sh. Halim Xhelua që *kqyrës* i shkollave të Vlorës më 1920.

goráq-e mb.; që është i humbur, i pa aftë për asgjë. Lere atë aty, ay është fare *goraq*, se fut në punë për asgjë.

kérc- ndf.; fringo, krejt të reja. Ishte veshur *kérc* me të reja.

kërce-ja f. sh. -e, -et; kore buke. Nëm tule e jo *kërce*, se nuk e ha dot.

kurkuvíq-i m. sh. -ë, -ët; lakuriqi i natës. *Kurkuviqët* rrojnë nëpër shpella dhe fluturojnë natën.

kasníq-i m. sh. -ë, -ët; gatimi që shpinte si peshqesh nusja kur vinte në ndonjë lindje ose në ndonjë dasmë. P.sh. Ç'*kasniq* pruri nusja.

kanxhél-i m. sh. -ë, -ët; lojë fëmijësh, e cila ndërtohet me një dërrasë që vendoset mbi një dru të shkurtër në dhe, mbi të cilën hypin fëmijët në të dy anët e saj dhe koloviten; kolovajse. Kush e ka ndërtuar këtë *kanxhel*?

kërcalídhe mb.; e thekur aq shumë sa kur hahet bën kërc-kérc në gojë. Qënka bërë *kërcalidhe* buka.

këmbëfërrë mb.; që sjell prapësi në shtëpi. Ik more (moj) se ti je *këmbëfërrë*, kur të del përpara të vete prapë puna.

kërcipátës mb. dhe m. sh. -, -it; ai që i ka kërcijt e hollë shumë si të patës. E shihni sa bukur kërcen ai kërcipatësi?

korkovínë-a f. sh. -a, -at; çiban me qelb që del në ndonjë pjesë të trupit. I ish mbushur trupi plot me *korkovina*.

kërcitharë mb.; që i ka kërcijt e hollë e të tretur, pa mish. Ai është fare *kërcitharë*, se si qëndron në këmbë, s'e di!

këmbëcipál-e mb.; që i ka këmbët shumë të holla. Ku ka takat ai plak *këmbëcipal*!

kokëdhí mb.; që është kokëfortë, kryeneç. Ik more, ti je *kokëdhi*, s'binde kurrë!

kokërródhe mb.; që e ka kokën e vogël dhe me flokë të këqinj. Ai *kokërródhe* ta shpif kur të del përpara.

kokëmýqe mb.; që e ka kokën e fortë, i padëgjueshëm. Ai është *kokëmýqe*, s'i mbushet mendja kollaj.

kokëúhur mb.; 1) që nuk e ngre kokën lart në sy të së shoqes ose të shokut, sepse ka bërë ndonjë turp; i turpëruar. Ai e turpëroi vehten, mbeti *kokëúhur* për jetë! 2) përdoret edhe për njerëz të urtë e të patrazuar. Ai i shkreti është *kokëúhur*, s'trazohet me punët e botës.

káptë-a (e) f. sh. të kapta-t; vend i futur, i fshehur matanë bregut. E për-zura, po m'u fut në një *të kaptë* e s'e pashë dot më.

këmbëlëpur mb.; i shpejtë në të ecur e në punë. Ai është gojëqepur e *këmbëlepur*.

leshrakaçurrél-e mb.; që i ka flokët kaçurrela, të dredhura. Ajo vajza *leshrakaçurrele* është më e lezeçme se ajo bjondja.

lëtýrë-a f. sh. -a, -at. 1) Uji i ndyrë që del kur lahen enët. Derdhi këto *lëtýra* që janë në këtë enë! 2) Qumështi kur i është hedhur shumë ujë. Ka ndonjë pikë *lëtýrë* të bëj përsesh apo jo.

letërshpërndárës-i m. sh. -a, -at. Ai që shpërndan letrat, postjeri. Erdhi *letërshpërndarësi*, mbase na ka prurë ndonjë letër nga djali.

lëkurézí-u m. sh. -j, -jt; njeri me lëkurë të zezë, jevgjit. Rroftë Partia që i ngjalli e i bëri njerëzit me të drejta të barabarta edhe me *lëkurëzinjtë!*

leshrandërrýdh-e mb.; që i ka flokët të përdredhura prej natyre, flokë kaçurrel-e. Golin e parë e bëri sportisti *leshrandërrýdh*.

lëkurédërr-e mb.; që e ka lëkurën të trashë, të fortë, që s'do t'ja dijë punës, që e duron shumë dhembjen fizike. Bjeri sa të duash, dëgjon ai *lëkurédërr?*

leshprérë mb. dhe em. f. -a, -at; ajo që i ka leshrat të prera shkurt. Përdoret shumë sidomos në fshat. Pse si ato *leshprerat* e qytetit do bësh edhe ti? Në mënyrë figurative thuhet për gratë që u vdes ndonjë njeri i tyre shumë i afërt. *Leshprera* ti ç'të gjeti!

mendjepërpíshur mb.; që mendon për shumë gjëra përnjëherësh, që e ka mendjen e shpërndarë, që bëhet merak për njerëzit që i ka në vende të ndryshme. Si unë dhe im shoq jemi *mendjepërpishur*, një djalë e kemi ushtar, një të sëmure në spital.

magjërrí-a f. sh. -të, vendi ku mbahet magjja dhe ku gatuhet buka. Më përpara *magjërria* ish shumë e madhe se e gatuanin bukën vetë në shtëpi.

majthítem vetv.; zihem, prishem, bëj fjalë e nuk shkoj mirë me shokun. *Jam majthitur* pakë me vëllanë e nuk flas.

mendjefjétur ndajf.; me mendjen të fjetur, pa merak. E, qysh thua, do më mbarosh punën, të rri mendje-fjetur?

mushkash-i *m. sh.* -ë, -ët; cchap me lesh të përhimë. Na këtë zile e varja *mushkashit*.

múshkër (i, e) *mb.*; i përhimë, cchap ose dhi me lesh të përhimë, mushkashë. Ajo dhia e *mushkër* sepse çalon nuk e di.

muzháqe-ja *f. sh.* -e, -et; të brendshmet e berrit kur janë të pamajme, të ligëta; përdoret edhe për mishin kur është i dobët. Ç'i ke dashur këto *muzhaqe*, s'kish më të majme?

mburreckamádh-e *mb.*; që mburret, që mbahet me të madh. Ama je një *mburreckmadh* ti që s'ke shok!

mburréckë-a *f. sh.* -a, -at; lëvdatë e palezeçme për vetëveten. Lere shejtanin është tërë *mburrecka*!

mjekërthádër *mb.*; që e ka mjekrën të kthyer nga jashtë, mjekërkizë. Ik more, *mjekërthadër*, tutje!

mavri-a *f. sh.* -, -të, bojë që e nxjerrin fshatarët nga fletët e një bime, me të cilën ngjyeyjnë rrobat e leshta në ngjyrë të zezë.

mustaqekacórr-e *mb.*; që i ka mustaqet të kthyer nga lart e të holluara në majë. Hajde *mustaqekacorr* hajde; pse të mos i dredhç ato mustaqe ashtu, ja ke kohën!

mustaqepëdrédhur *mb.*; që i ka mustaqet të gjata e të përdredhura. Burri im i zgjedhuri, *mustaqepërdredhuri*.

mendjefýell *mb.*; që është i trashë nga truri, që s'ja pret mendja fare. Hajde *mëndjefyell*, hajde, s'ta pret kungulli fare!

monoshqép-i *m. sh.* -ë, -ët; i thatë që del diku në trup dhe qelbëzohet, çiban. Më ka dalë një *monoshqep* e më dhemb shumë.

ndyrepështýrë *ndf.*; të pështirë, ndyrazi. E hëngrëm këtë gjellë, *ndyre-pështyrë* e mu prish mideja.

nur-zí — nurzézë *mb.*; që rri gjithënjë i vrejtur, që i nxin fytyra. Ama ç'nurzi që është ai, s'i qesh një herë buza. Gjithnjë *nurzezë* ajo lumëmadhe.

ozdronék-u *m. sh.* -ë, -ët; njeri me trup të madh, të shëndoshë e të lidhur. Moore, ç'ozdronek qenka ai!

ormí-a *f. sh.* -, -të; dhuratë, peshqesh, gatim që shpiket në ndonjë lindje ose ngjarje gazmore. P.sh. Vajte me *ormi* te filaneja që i lindi djalë?

osht! pasthirmë që përdoret për të larguar qenin. *Osht*, zagat, se na trembe fëmitë!

plekësírë-a *f. sh.* -a, -at; 1) ngatërresë, mosmarrëveshje, grindje. Kemi një *plekësirë* me të e s'mund ta gjejmë fjalën. 2) marrëdhënje krushqie. Ç'jini ju njëri me tjetrin? — Kemi një *plekësirë*, jemi krushq.

pirivíl-e *mb.*; që e ka karakterin të paqëndruar, që i ndërton mendja menjëherë; përdoret edhe *pilivruq*. Ti je pirivil, ç'thua sot s'thua nesër.

pipizáne-ja *f. sh.* -e, -et, një lloj bilbili fëmijësh që bëhet prej një kallami të hollë e të gjatë rreth 20 cm., të shpuar nga brenda dhe me disa vrime përsipër, që përdoret për t'i fryrë si vegël muzikore.

paranóm-i *m. sh.* -e, -et; emër që i ngjitet një njeriu me tallje, që ka të bëjë me ndonjë të metë fizike ose morale; nofkë. Mirë emrin që e mora vesh, po *paranomin* si e ke?

pahírtë (i, e) *mb.*; i zhvilluar keq nga trupi, me shëndet të dobët. Si djalë *i pahirtë* më duket ai, mbeti në vend, as poshtë as lart s'bën, nuk zhvillohet fare!

píkur (i, e) *mb.*; i varfër në kulm, që s'ka asgjë pas shpirtit. Është *i pikur* i shkreti, sa më vjen keq!

qejfpapríshur *mb.*; që nuk prish qejf, që mundohet t'i kënaqë të gjithë. Ai është njeri *qejfpaprishur* e punëpabitisur.

qafëthýer *mb.*; që ka pësuar ndonjë fatkeqësi, dhe që nga kjo e mban kokën poshtë. Lere atë *qafëthyer* se ç'e gjeti!

qafók-u *m. sh.* -ë, -ët; ai që e ka qafën të shtrembër, të kthyer në një anë. E di sa i zgjuar është ai *qafoku*?

rrushkullój *kal.*; prish qejf, dëshpëroj. Më *rrushkulloi* vdekja e nënës!

rrushkullím-i *m. sh.* -e, -et; dëshpërim. S'm'u ndanë *rrushkullimet* në këtë dynja!

rrushkullúar (i, e) *mb.*; i dëshpëruar. Vdiq *i rrushkulluar* i shkreti, se nuk la njeri pas!

rrëzómë-a *f. sh.* -a, -at; breg a çdo send tjetër që është në të rrëzuar e sipër. Mos rri nën *rrëzomë*, se mund të rrëzohet dhe të të shtypë!

rrushkúqe-ja *f. sh.* -, -t; lulesa e lofatës me ngjyrë trëndafili që hahet se është e ëmbël.

shtatlastáre *mb. dhe em.*; që e ka shtatin të gjatë, të hollë e të bukur si lastari i bimës. Ajo nazemadhja, ajo *shtatlastarja* (pop).

skordhán-i *m. sh.* -ë, -ët; sallatë që bëhet me kos, kastraveca të rënduar, hudhra dhe vaj; tarator. Darkë për darkë ha *skordhan* me hudhra e me kos.

sypíshë *mb.*; që e ka syrin të gjallë, që rrëfen një mendje të zgjuar. Ai është *sypishë*, s'i trëmbet së keqes.

syzhiválle *mb. dhe em.*; që e ka syrin në ngjyrë të hapët si guackat e molusqeve, që në gjuhën popullore quhen «zhivalle». Ajo mëndjemadhja, ajo *syzhivallja* (pop).

shqelebón-i *m. sh.* -ë, -ët; pjepër i pjekur shumë dhe i kalbur përbrenda aq sa nuk hahet dot. Pse i ke blerë këta *shqelebone*, këta s'hahen as nga pulat.

sheftís *kal.* -a, -ur; shkoj, vë fillin në gjilpërë. *Sheftise* fillin dhe bjema gjilpërën këtu!

shabáte-ja *f. sh.* -e, -et; këpucë e vjetër pjesët e së cilës mund të përdoren për arnesa. Shiko mbase i shet ato *shabatet* në ndonjë mballomaxhi.

shalavrák-e *mb.*; që i ka shalët e gjata. Kush është ai *shalavrak* që po duket atje tutje.

trutúl-e mb.; budalla, i trashë nga truri, jo inteligjent. Ai (ajo) është *trutule*, s'kupton fare!

tomóllë-a f. sh. -a, -at; dorezë prej metali që i vihet sirtarëve ose kapakëve të mobiljeve dhe shërbejnë për t'i hapur ato. Bleva dy *tomolla* për një komodinë.

tárbe mb.; 1) që është e tharë shumë, e ngrirë. Ç'është kjo bukë *tarbe* që s'hahet dot. 2) në kuptim figurativ përdoret për një njeri të padëgjueshëm, kokëfortë. Nuk bindet, e ka kokën *tarbë*.

torobócka-t efsh. të brendshmet e berrit (zorrët, etj.) Paske blerë gjithato *torobočka*!

trakalíçe-ja f. sh. -, -t; kokërr fiku e vogël dhe e papjekur me të cilat lozin fëmijët e vegjël. Më pëlqejnë shumë *trakaçet* e njoma të loz me to!

turilëshúar mb.; që rri gjithnjë i vrejtur, i zemëruar, me turi të varur. Gjithnjë *turilëshuar* ti ore i zi, sikur të ka ngrënë gomari bukën!

tumanár-i sh-ë em.; shpez i madh me sqep shumë të gjatë me pendë të bardha si në trëndafil; pelikan. Ballsamosa një *tumanar* të bukur.

truphédhur mb.; që ka lëshuar shtat por pa e patur moshën. Është vajzë *truphedhur*, pa nuk është e madhe në moshë.

topllambáq-e mb.; që është i shkurtër dhe shumë i shëndoshë, i fryrë si top. Shikoje atë gruan *topllambaqe*, mezi ecën!

veshcíp mb.; që i ka veshët shumë të vegjël. *Veshcip* është ai, po dëgjon shumë.

vithí-a f. sh. -, -të; dhé që është rrëzuar nga një vend më i lartë dhe nuk ka zënë vend, themel. Mos flij nën atë *vithi*, se munt të rrëzohet e të shtyp.

vurxós kal. a; -ur; ngjesh, shtyp me fuqi të madhe, mbasi ta kem mbushur diçka (enë, thes, trastë etj.) E paske mbushur e *vurxosur* si shakull. Përdoret edhe për plagët kur mërihen e ajten. Qenka *vurxosur* plaga.

veshandéze-ja f. -, -t; në figurat mitologjike, një kafshë e çuditshme, që gjoja dëgjon shumë. Përdoret për ata njerëz që dëgjojnë shumë. O asllan, o kapllan, *veshandeze* ku të kam? Qenke *veshandeze*, ku më dëgjove kaqë shpejt, unë fola shumë ngadalë.

zémërt (i, e) mb.; guximtar-e. Selman Hyseni nga Tërbaçi ka qënë *i zemërt*, s'donte t'ja dinte italianit në Luftën e Vlorës.

xambák-u m. sh. -ë, -ët; kërci. U rrit more, nuk e sheh se iu bënë *xambakët*.

xhixhillëke-t efsh.; pizhama. Bleva një palë *xhixhillëke* dimri.

xhepshpúar mb.; që prish shumë para, që s'i mbetet një gjë në xhep nga ato që fiton. Te ai do kërkosh hua ti? Ai është *xhepshpuar*, s'i mbetet lek në xhep.

xhixhiválle-ja f. sh. -, -t; guacka deti që mbledhin fëmijët. Mblodha në det gjithato *xhixhivalle*.

xhórre-ja f. sh. -, -t; shkop i madh, i trashë e i pagdhendur. Shko në pyll e pre një *xhorre* ta kesh se mos të hanë qentë e filanit!

zhákë-a f. sh. -a, -at; çfarëdo rrobë e vjetër, velenxë ose çull. Hidhmë atë *zhakë*, se mbërdhahet. Qënka bërë *zhakë* palltua, s'u mbajtkja më!

UAN ÇINA

Frazeologji të mbledhura në Myzeqe

ár/ë,-a f. E bën arë e hambull e hap një fjalë anakënd, ua tha të gjithëve. P.sh. Asprinë po ti e njeh, *arë e hambull* i bën të gjitha fjalët që dëgjon, llafazane grua.

báth/ë,-a f. Bathë, bathë, një kokërr po në një vend, pa asnjë ndryshim, gjithënjë të njëjtin avaz.

P.sh. Ama ti, të njëjtën gjë na thua, *bathë, bathë, një kokërr*. Thuaje shqeto do ta bësh a s'do ta bësh?

bëj kal. Të bën përse të përfill, të sajdis, të respekton.

P.sh. Jo more, të jatin e kanë të mirë ata, *të bën përse*, po ata janë bërë hundëpërpjetë.

bisht,-i m. Do (kërkon) thelë mbi bisht kërkon më tepër se ç'duhet, nuk ngopet me atë që ka.

P.sh. Mirë e ndamë ne lëndën e pyllit, po atij s'i mbushi syrin hiseja e tij, *donte thelë mbi bisht*.

Bën kokë (krye) nga bishti, bën çdo gjë për t'ja arritur qëllimit, s'lë gur pa lëvizur për t'ja dalë në krye një pune.

P.sh. I lumtë Lonit për atë djalë, si bletë e plotë e ka, *bën krye nga bishti ai*.

bodéc,-i m. S'ha bodec nuk ka nevojë për shtyrje, gjithëçka e bën vetë. P.sh. Xhibër e ka atë të voglin ai, djalë që s'ha bodec, është edhe i zgjuar xhanëm.

brázd/ë,-a f. Vënë brazdë fut në binarë, vë në udhë të drejtë. Vihem në brazdë shtrohem, hyj në binarë, vihem në udhë të drejtë.

P.sh. Ai Lami na ka hapur punë, nuk *vihet në brazdë* fare, s'ja kthen dot kokën. Po për të gjetur e ka kokën e kandilit.

búz/ë,-a f. Buzë gjyshi shumë i ftohtë.

P.sh. Hajde ha bukë o Leksi, se u bë *buzë gjyshi* gjella.

buzëbárdhë mb. Sa gomarë buzëbardhë (ka)! (iron), s'është ajo gjë, s'është ai ose s'është e atij që mendon ti, ka edhe të tjerë si ky.

P.sh. Jo more, s'është Liçi ai, *sa gomarë buzëbardhë ka*, ka edhe të tjerë që çalojnë. E pse ta jap ty portofolin? Portofolë me sustë ka plot. Sa gomarë buzëbardhë ka po të tutë janë?

byrék,-u m. Ta pjek byrekun, (tallëse) ta bën gropën, të vret, të zhduk.

P.sh. Hajde, grek, hajde, pa ta *pjek byrekun* shqiptari. Mos iu afro kalit, se ta *pjek byrekun* ai.

çapók,-u m. sh. ë, -ët. Ka çapokë. a) është i aftë, është i zoti, ka fuqi për t'ja arritur diçkaje.

P.sh. Thuaji Vangjelit ti, se ai *ka çapok* për këtë punë. b) *ka ecje* të shpejtë, *çap* të lehtë e të shkathët (për kafshët e punës).

P.sh. Të dy qetë e tij *kanë çapokë* të mirë.

çirák,-u *m.* *Nuk la çirak ndezur* nuk la fëmijë pas vdekjes, iu mbyll shtëpia.

P.sh. Vdiq Toni i shkretë dhe *nuk la çirak ndezur*.

derr,-i *m. sh.* -a, -at. *E piu derri* u prish krejt, u dëmtua, mori fund.

P.sh. Ruhu sa s'është bërë zarari, se po u bë, e *piu derri*, s'ke ç'i bën më. Mos ja lërë atij zamzanen (= damixhanin) në dorë, se e *piu derri* dhe qaje pastaj.

dór/ë,-a *f.* *Bëhem dorë* i hyj një pune për ta mbaruar, i vë shpatullat një pune dhe nuk e lë pa mbaruar.

P.sh. Kozi e di ç'ka hequr me atë shtëpi. Po *u bë dorë* edhe Rakua që e mbaroi, se do të mbetej jashtë edhe këtë dimër. Lere atë, se *s'bëhet dorë* ai, s'ke ç'e do që e thërret.

drit/ë,a *f.* *Dritë në diell!*, (*iron.*) që s'është më i mirë se të tjerët, që merret si më i mirë po në të vërtetë s'është ashtu.

P.sh. — Pali s'e ngrë dot thesin, po thirri Uanit. — Ama e gjete, se ai *dritë në diell!*

dyfék,-u *m.* *Plasi Muçua për dyfek* (*tallëse*) mezi paska pritur të ngrihet, i pëlqeka pozita, dashka të tregojë fuqinë e zgjuarsinë e vet, paska plasur për të komanduar.

P.sh. *Plasi Muçua për dyfek*, shyqyr që e vunë kryetar Vangjelin dhe do të na tregojë mendët e tij të bukura!

dújk/ë,-a *f.* *I jap dujkat* e përzë, i jap udhët.

P.sh. Është shastisur çuni se i *dha dujkat* i jati.

Marr dujkat arratisem, marr malet, iki nga sytë këmbët.

P.sh. Ika, moj, ika, *mora dujkat-o* / Për ty s'më zë gjumi natën-o. (pop)

dýll/ë,-i *m.* *Bukë dylli* shumë i verdhë.

P.sh. U bë *bukë dylli*, kur i foli i ati. Nga sëmundja më është bërë çupa *bukë dylli*.

Dyllë zoge shumë i verdhë e i pastër, si qelibar, si dylli i bletës së re.

P.sh. Gjaldi i mirë është *dyllë zoge*.

dhi,-a *f. sh.* -, -të. *I erdhën dhitë*, i erdhën mendtë, u mblodh, u shtrua.

P.sh. Më përpara ishte shumë fodull, po tani i *erdhën dhitë* e u shtrua.

ér/ë,a *f.* *Ç'erë fryjti?! Ç'e mirë të solli?! Ç'qe kjo mbarësi?!*

P.sh. *Ç'erë fryjti* moj Konxhe që na erdhe, se na u bëre firare.

fóret *vetv.* Shkon shtrembër, ngec.

P.sh. Kur po hante drekë, iu *for* buka dhe desh u mbyt.

frýer,-i *m. sh.* -ë, -ët. Një si rubinetë prej druri që u vihet vozave të ujit, të verës etj.

Ikën fryer voze rrjedh çurg, derrdhet me curil të madh.

P.sh. Kur preu këmbën Dhori, gjaku i *ikte fryer voze*.

gísht,-i *m.* *Mbeti gisht* a) *Mbeti* pa gjë, pa pasuri, pa asnjë plaçkë, mbeti lakuriq.

P.sh. I ra zjarri shtëpisë dhe *mbeti gisht* i ziu.

b) Mbeti pa njeri, mbeti i vetëm.

P.sh. Kur ra kolerja në kohën e Austrisë, i vdiqën robt e shtëpisë një nga një e *mbeti gisht*.

gójë,-a f. *Më ra goja* jam marrë shumë me një çështje, kam folur a kam kërkuar shumë diçka.

P.sh. Jepi çunit të hajë se i *ra goja*. More mua më *ra goja* duke i folur po s'merr vesh ai. *Më ra goja* duke ja kërkuar borxhin, po ai bën veshin shurdhër.

gorric/ë,-a f. *Shet gorrica* thotë budallallëqe duke dashur të shesë mend, thotë gjëra të papjekura.

P.sh. Po ti ç'po *na shet, gorrica?* Mburracak! Lëre se të njohim kush je!

gur,-i m. *Koqe guri* shumë i fortë, i fortë gur.

P.sh. E ke zjerë shumë vezën, është bërë *koqe guri*.

Ishte tharë buka e ishte bërë *koqe guri*, ta prisje me naxhake. Ore, mos u ha me të ti, është *koqe guri*, ai, se është çun i ri.

Të mirët e gurit (e thënë për kuptim të kundërt) një e mirë që s'është; përkundrazi në vend të saj është një e keqe, ashtu sikurse nuk mund ta gjesh të mirën te guri.

P.sh. — Ti tashi, mirë je? / — *Të mirët e gurit* jam. Vdekjen, thuaj, ku e kam?!

gjemb,-i m. *Kërkon këmbë për gjemb* kërkon shkak për sherr, kërkon njeri të grindet; lëshon brezin për sherr.

P.sh. Kudo potere bën ti, gjithnjë *këmbë për gjemb kërkon*, fut hundët këtej, ngacmo andej.

gjú,-ri, m. *Nguli gjunë* u shtrua mirë për drekë a darkë, nuk luajti vendit. P.sh. *Më ardh* Aliu i beut, *nguli gjunë* dhe një javë m'i faroi (= shfarosi) pulat.

I dëgjon gjuri mund të punojë ende, është akoma në gjendje, megjithëse është plak.

P.sh. Spiros *i dëgjon gjuri* akoma, nget; në arë, mbjell e korr.

ha kal. *Ha të hequr* zgjat shumë, zvarriset, vonohet.

P.sh. Sipas terezisë *ha të hequr* kjo punë, prandaj durim.

hu,-ri m. *Nuk lidhet në një hu* është i lëkundur, nuk mban të njëjtin qëndrim, merr sa një anë anën tjetër.

P.sh. *Nuk ujdise dot me të, se nuk lidhet në një hu* ai, sot të thotë kështu, nesër tjetër gjë.

húnd/ë,-a f. *I hyj ndër hundë* e bind me këmbëngulje, ja ha kokën me të mirë.

P.sh. S'ju nda ai, *i hyri ndër hundë*, vër sot vër nesër e më në fund e bindi.

jastëk,-u m. *Vëri jastëk fjalës!* folë me mend, mbështete fjalën që thua, mos folë pa baza.

P.sh. Ti mos ja mbyl kot mor vëlla, po *vëri jastëk fjalës* se s'ta vë veshin njeri.

kálë,-i m. sh. kuaq,-t. *Më kalin e babait* (për shaka) më këmbë.

P.sh. — Me çfarë do të shkosh nesër në Fier ti? — *Ma kalin e babait*.

Cili kalë zihet në lëmë kë zënë me presh në duar, ai përgjigjet për dëmin. P.sh. Mbase kanë marrë edhe të tjerë misra, po i pagoi çuni i Kovit, se atë kapën, si i thonë fjalës: «*cili kalë zihet në lëmë*».

kamástër,-a f. U bë kamastër u nxi në fytyrë nga zemërimi i madh, nga inati.

P.sh. Plasi nga inati, u bë kamastër, po s'kishte ç'të bënte, se vet ishte fajtor.

kártë/ë,-a f. Kartë cigari shumë i bardhë.

P.sh. Sa mirë e lau këmishën, kartë cigari e bëri.

kopác/e,-ja f. Mbeti si kopaçe mbeti fare vetëm, pa njeri, iu mbyll shtëpia. P.sh. Djalë s'kishte, çupat i martoi një nga një dhe mbeti si kopaçe lumi në shtëpi.

krúshk,-u m. S'po i vinë krushqit në bythë të arrës s'e ka me aq ngut, pret puna, s'është domosdo aq e shpejt puna.

P.sh. Po rri ore dhe një çikë, pse nxitohesh kaq shumë, s'po të vinë krushqit në bythë të arrës, de!

kullój jokal. Më kulluan sytë (për diçka a për dikë). Kam shumë dëshirë e mall të kem diçka a të shoh dikë, jam përvëlur për diçka a për dikë. P.sh. Në kohën e kaluar myzeqarit i kullonin sytë edhe për një çikë dhallë. Po ku je, moj Ksandë, më kulluan sytë për ty, një vit që s'na ke ardhur.

lájmes,-i m. Mish pas lajmësi porosi pas porosie, duke e përcjellë dorë më dorë a njeri më njeri, jo drejtpërdrejt; në mënyrë të pasigurtë.

P.sh. I thashë Todit t'i thotë Kolit që të marrë edhe plaçkat e mia, po nuk bësoj se mish pas lajmësi është kjo punë kështu. More, do të ma mbarosh vetë ti këtë hall, apo do ta lësh fare, se mish pas lajmësi nuk dua unë, jo «t'i them këtë», jo «t'i themi atij».

larásk/ë,-a f. Për bar të laraskës për hiçgjë, kot, për pesë para spec.

P.sh. Vajti në pazar për bar të laraskës. U zemërua dhe mban mëri për bar të laraskës.

lesh,-i m. Lë leshin në vrimë e pësoj mirë, dal me dëm të madh nga një punë.

P.sh. Mora një qerre dru në pyllin e beut, po ç'e do lash leshin në vrimë, se vrava qetë nga që i ngava shpejt.

lëm/ë,-i m. Para në lëmë para të hedhura në erë, që ja jep një tjetri me shpresë t'i marrësh kur të ketë me shumicë.

P.sh. Do para në lëmë ti or burazer, po unë s'i kam të tepërta dhe kam nevojë vetë.

límë,-a f. Jam bërë limë kam sharruar për të ngrënë, kam uri të madhe.

P.sh. Dy ditë në rrahë ore, isha bërë limë nga kazma dhe doja një furrë bukë.

líp sur palak. Qoftë lipsur! S'ke ç'e do, s'e vlen barra qiranë. Qoftë lipsur kjo puna jote, më shumë ke bërë rrëmujë se ke pastruar. Edhe ky peshku qoftë lipsur, të fut plevitin sa ta zesh. Qoftë lipsur dhe ajo që ma dhe, ma ke kujtuar dhjetë herë.

lúm/ë,-i m. Vajti për lumë vajti dëm, s'vlen më, u dëmtua shumë.

P.sh. Preva gjithë ato perikota në Kaninë, po ç'e do, *vajti për lumë*, se i zuri shiu jashtë e i bëri baltë.

mác/e,-ja f. I bëhet mace i vjen neps, ka neps të madh për diçka.

P.sh. Është grua me barrë ajo, i bëhet mace për çdo gjë, po kumbullat e tharta i bëhen mace fare.

mbin jokal. E hedhura poshtë *mbin* në kopësht një gjë që duket e pavlefshme mund të dalë e dobishme vetiu.

móll/ë,-a f. *Vajti te molla e kuqe* u përhap shumë, mori dhenë (për fjalët etj.)

P.sh. Turpi që bëri ai *vajti te molla e kuqe*, ti më thua «mos i thuaj njeriu».

morr,-i m. E rjep *morrin* nga bishti është koprac i madh.

P.sh. Atij s'ja pi njeri kafenë, asnjë sheqerllëke nuk u sjell kalamanjve. nga pazari, e rjep *morrin* nga bishti.

mbledh kal. Ja *mbledh rretrat* ja *mbledh rripin*; e disiplinonj.

P.sh. Me të s'bëhet shaka o vëlla, të *mbledh rretrat* ai, s'ka llafe.

mbllë palak. E vuri *mbllë* e vuri vëth në vesh, e vuri në xhep e ruan rastin për t'u hakmarrë.

P.sh. S'është njeri i mirë ai, një herë e kritikuan dhe e vuri *mbllë*, po pret shtegun të marrë hak.

I *mbeti mbllë* i mbeti merak, i ngeli mendja.

P.sh. Priti dy orë tek porta, po i *mbeti mbllë* se nuk e takoi atë që priste.

mýk/ë,-a f. I pret dhe *myka* i shkon fjala, s'i bëhet fjala dysh.

P.sh. Atij thuaji ta rregullojë këtë punë, se atij i *pret dhe myka*.

mýkem vetv. I *myket buka*, s'është fare i zoti, s'të nxjerr nga balta, është i ngathët e përtac.

P.sh. Luaji duart të shkretën, mos bëj si Ndoni i Xoxit që i *myket buka*.

nakatýr/ë-a f. 1) Rrëmujë, zallahi.

Kur erdhi Balli në fshat e bëri një *nakatyrë* këtu, që s'e merrte vesh qeni të zonë.

2) Përzjerje, turbullim.

P.sh. Më vjen *nakatyrë* në bark, si për të vjellë.

ngrýsem jokal. Është *ngrysur larg* s'ka haber fare, s'di fare për diçka.

P.sh. Ama paske gjetur njeri të qash hallin, ai është *ngrysur larg* nga kjo punë.

ngjál/ë,-a f. Kokë *ngjale* që s'ka gjë me përfitim, prej të cilit s'nxjerr dot gjë, që s'jep gjë.

P.sh. Sado ta ekonomisje bukën më përpara, ajo s'dilte, *kokë ngjale* ishte.

opíng/ë,-a f. Gurë në *opíngë* që të bezdis e të pengon.

P.sh. Më është bërë *gurë në opíngë* një muaj të tërë ai, ma ka sjellë në majë të hundës.

papréré (i, e) mb. Bletë e *paprerë* i pasur, i kamur, i zënë nga gjendja, i paharxhuar.

P.sh. E bëri shtëpinë me dy kate ai, me tullë e me qeramidhe, është *bletë e paprerë*, fëmijë iu rritën.

peshqir,-i *m. sh.* -ë, -ët. *Erdhi me peshqir në brez* erdhi (në dasmë) pa peshqesh, erdhi për të ngrënë e për të pirë pa sjellë gjë vetë.
P.sh. Si s'i erdhi turp! Erdhi me *peshqir në brez* vetë, gruaja dhe kalamanjtë.

pil,-i *m.* *Pil më pil* breg më breg, cep më cep, ngado.
P.sh. I shpëtoi derri nga litari dhe e ndoqi *pil më pil* sa mezi e zuri.

pipëz,-a *f.* *I ranë pipzat* u shtrua, i ranë pendët, s'hedh më vickëla.
P.sh. Më përpara s'të këndonte me gojë, po tashi i *ranë pipzat*, është bërë me terbiere të mira.

pirr/ë,-a *f. sh.* -a, -at. Një lloj bari me gjethe të gjata e të mprehta, që rritet rreth një metër i lartë, zakonisht në vende moçalore.
Ja *di pirrën* ja di të gjitha, me rrënjë e me degë, ç'ka e nuk ka.
P.sh. Është e kotë që fshihet ai, unë e njoh mirë, ja *di pirrën*.

plák/ë,-a *f.* *Si plaka gjënë* me drejtësi, pa hatëre.
P.sh. Akçeshë mora të shoqen e Lilit, ajo ndan *si plaka gjënë*, është e mirë.

plënc,-i *m.* *Plënc i palarë* një gjë që vlen, por që s'ka të dukur.
P.sh. Sa e mirë doli nusja e Prendit! Kur ishte çupë e vogël s'ta mbushte synë, pse thonë «çupa *plënc i palarë* është».

plór,-i *m.* *Majë plori* shumë i ftohtë, akull.
P.sh. E kam djalin sëmure. *Majë plori* është bërë nga këmbët.

prápt/ë,-a (e) *f.* *S'i del nga e prapta e dorës* është koprac i madh, është shumë dorështëruar.
P. sh. Nuk ke as ndihmë as hua nga ai ti, është dorrac i madh, *s'i del nga e prapta e dorës* atij.

pus,-i *m.* *U bë tas pus* u zhduk pa lënë gjurmë, humbi e s'e gjen dot asgjëkund.
P.sh. Më humbi vjet lopa, *u bë tas pus*. Ç'u bë kjo e shkretë shami? *U bë tas pus*. More, po ti u bëre *tas pus* fare, ka që hane që s'të kam parë.

qoshé,-ja *f.* *Të qan qoshenë* bën gjithëçka, e kryen një punë me art dhe çdo punë ja del në krye.
P.sh. Është plak i mençëm ai, *të qan qoshenë*.

qyp,-i *m.* *Si miza në qyp* që s'ndihet qartë, që flet mbyturazi.
P.sh. Nuk të kuptoj çfarë thua, se flet *si miza në qyp*.

rrap,-i *m.* *U bëra rrap e rrënjë* jetova shumë.
P.sh. *U bëra rrap e rrënjë* unë or bir, kam parë shumë e kam dëgjuar shumë. Gjyshja jote *u bë rrap e rrënjë*, vdiq njëqind vjeçe.

rrík/ë,-a *f.* *Ja lë rrikën* ja lë fajin dikujt, ja hedh atij fajin, gënjej, mashtroj.
P.sh. Pandehte se e kishte punën mirë me Spiron ai, se do të merrej vesh, po ai *ja la rrikën*.

rrúshkull,-i *m.* Rrush i egër, i rrallë e i thartë. *U bë rrushkull* u varfërua, ra ekonomikisht, u shkund nga harxhime.
P.sh. E martoi djalin, bëri goxha dasmë, po ç'e do se *u bë rrushkull*.

sý,-ri sh. -, -të. *I zë sytë* ja plotësoj një kërkesë shkel e shko, në mënyrë gjysmake, sa për t'i zënë gojën.

P.sh. E more, se e njohim atë. I bën punët sa për të zënë sytë. Shpejt e shpejt i gjeti një qerre rrënjë, i zuri sytë.

Sytë nga qielli, duart nga mielli që s'e ka mendjen aty, që bën një punë pa kujdes.

P.sh. Edhe prashitja do mend, jo *syte nga qielli e duart nga mielli*.

shamí,-a, f. *U bë për shami* u gëzua shumë, aq sa t'ja marrë valles me shami.

P.sh. Kur mori vesh Likua për trimëritë e të birit ushtar, *u bë për shami*.

shég/ë,-a, f. *Më qafsh moj shegë!* (tallëse) që s'vlen fare, që s'të hyn në punë, që s'ke ç'e do.

P.sh. Të gjithë që më ke dhënë sot për dru, *më qafsh moj shegë*, gjeti tenxhereja kapakun.

shoh kal. *Sa për shihni botë* sa për sy të botës, për t'u dukur, për të treguar veten para të tjerëve.

P.sh. Tashti që erdhi brigadieri punon ti, *sa për shihni botë*. Duhet të punosh gjithnjë kështu. Po dhe brigadieri *sa për shihni botë* erdhi, ndënji pesë minuta e krisi iku.

shpátull,-a f. *Heq në shpatull* i bën bisht punës, përpiqet t'ja hedhë tjetrit barrën e një pune, si ai kau në zgjedhë që tërheq nga jashtë.

P.sh. More çun, mos *hiq në shpatull*, se kjo është puna jonë, çdonjëri të punojë pa hile.

shtyj kal. *Shtyj balash përbrenda* me hile e pa kujdes, shkel e shko.

P.sh. Ai është i krisur, dhe punën *shty balash përbrenda* e bën.

tellós ndajf. ters, tjetër për tjetër, ndryshe.

P.sh. Vëri veshin mirë fjalës dhe mos e *merr tellos* muhabetin.

tërnáçkë mb. Mëndjelehtë, e papjekur.

P.sh. Pse shkon me mëndjen e saj ti? Ajo është *tërnáçkë*.

thán/ë,-a f. *Thana në shëndre* gjë e pamundur, qiçra në hell. P.sh. Ohu, ç'kërkon ti, *thana në shëndre*? Gjersa të thonë s'bëhet, s'bëhet.

thémbër,-a f. *Nuk ha bukë thembre* është qibar e fodull si i rritur me tul buke, bën shumë naze.

P.sh. Gjeta belanë me nipin, ma solli çupa dy javë, po *nuk hante bukë thembre* ai, gjithë ditën plaka me të.*

thýej kal. *Nga theva këmbën!* Pse vajta! ç'mu desh që vajta!

P.sh. *Nga theva këmbën* edhe unë që vajta tek ai, e dija që ai s'të priste mirë.

udh/ë,-a *Bën shtëpi në mes të udhës* është i zoti e i shkathët, i vjen gjithëçka përdoresh.

P.sh. Dëgjo moj bijë, djali është i mirë, i fortë, i punës, ai *bën shtëpi në mes të udhës*.

újk,-u m. *I kalla ujkun!* a) as që kam çarë kokën ta di.

P.sh. — Ku është Sotiri?! — *I kalla ujkun unë?* Pse atë po ruaj.

b) E braktisa, hoqa dorë prej dikujt a diçkaje.

P.sh. E punova tre vjetë atë shkorretë (= tokë e varfër), e pashë që s'bënte gjë dhe i *kalla ujkun*.

vá,-u m. E zuri vaun i hodhi hallet, i kapërceu vështirësitë.

P.sh. Vuajti ca, po iu çuan çunat dhe e zuri vaun tashi.

välë,-a f. Pikë e valë shumë i dëshpëruar, pikë e vrer.

P.sh. Kur i thamë se i vëllai u shtrua në spital, ai u bë pikë e valë. Kur e pa që s'ja mori njeri për bazë fjalën, u bë pikë e valë.

valóm/ë,-a f. E mori valoma e mori lumi, u shkatërrua (për njerëz).

P.sh. E mori valoma të shkretin Miti, lopa i ngordhi, qetë ja çau ujku, mbeti pa gjë.

véz/ë,-a f. Mban vezë në tundës ruan çdo gjë për dikë, e ka me kimet, e do dhe e përkujdes shumë.

P.sh. Të ka dhëndër të parë, prandaj ta mban vezën në tundës vjerra ty.

viç,-i m. E bën kaun me viç e bën të paqenën të qenë, shpif të paqena.

P.sh. Jo, po s'e lë më ta bëjë kaun me viç ajo, t'i vërë paranom e t'i hapë namin e keq vajzës kot.

yzéngji,-a f. Me këmbën në yzengji gati për të ikur.

P.sh. Çupa te babai, mor bir, është me këmbën në yzengji. Po t'i rri edhe ca, sa erdhe dhe me këmbën në yzengji.

zë kal. E zë shul a) zë keq një rrugë, një kalim etj., pengoj lëvizjen.

P.sh. Na e ke zënë shul me atë qerre, s'kemi nga shkojmë. Çohu, ore, se na e ke zënë derën shul.

b) E zë ters, ngul këmbë për një gjë me kokëfortësi, jam i prirur për të kundërshtuar gjithëshka.

P.sh. More e paske zënë shul sot ti, në punë s'do të vesh, me njerëzit po zihesh.

I zë dora a) i vjen ndoresh për çdo punë, nuk rri kot, kudo që është bën diçka.

P.sh. Llazit i zë dora, i bën punët e shtëpisë njësoj si grua.

b) I ka sukses çdo punë, i del mirë çdo gjë që bën.

P.sh. Ai është doktor, i zë dora atij, ma shëroi çunin për një muaj. Shko i thua Tolit ti, atij i zë dora për të pajtuar, po hyri ai në mes, i rregullon njerëzit.

zdrënkthi ndajf. E merr zdrënkthi rrëmbehet, nxitohet në gjykimin e gjërave.

P.sh. Në fillim e mori zdrënkthi, po që kur i folëm ka rënë në takatuke (= është shtruar).

zog,-u m. Nxjerr zogj a) lëngon, dergjet në shtrat.

P.sh. Lexi i shkret po nxjerr zogj, ka tre javë që s'ka luajtur nga shtrati.

b) Rri kot, s'bëj punë, rri për një kohë të gjatë në shtrat.

P.sh. Çohu, more dembel, zogj po nxjerr tërë ditën dhe lë gruan vetëm në arë.

MIHAL EKONOMI

Leksik i mbledhur në krahinën e Gjirokastrës

ritë-a f. sh. -a, -at; enë prej druri në formën e një govate, që përdoret për të grumbulluar dhe kulluar vajin e ullirit.

goblícë-a f. sh. -a, -at; enë druri që nxë 5-10 kg. ku grumbullohet qumështi i mjelë.

torík-u m. sh. -ë, -ët; grumbull njerëzish; Të bëhemi një *torik* i madh pastaj të shkojmë.

jóshë-a f. sh. -a, -at; gjyshja nga ana e nënës. Mama, ika unë, do të vete te *josha*.

babajósh-i m. sh. -ë, -ët; gjyshi nga ana e nënës.

milónjë-a f. sh. -a, -at; pushkë e vjetër me çark me një fishek.

flokádë-a f. sh. -a, -at; bërruc.

hakakáq-i m. sh. -e, -et; bretkosë.

bímbë-a f. sh. -a, -at; këmborë e madhe që e mban dashi çorës, kur dhentë zbresin nga mali ose ngjiten në mal.

drevenícë-a f. sh. -a, -at; enë druri në formë të rrumbullakët si bucela që përdoret për të mbajtur ujë ose verë gjer në 7 litra.

dúmbllë-a f. sh. -a, -at; këmborë e vogël, çokane.

gugumáne-ja f. sh. -et; insekt më i madh se zhuzhinga, me ngjyrë të zezë dhe helmues; kur fluturon gjëmon: Ruhë nga *gugumanet* se të hanë.

pjékë-a f. sh. -a, -at; përrua i madh dhe i thellë që kalon në mes dy kodrash të larta.

jakatár-i m. sh. -ë, -ët; rrobaqepës që rregullon jaka xhaketash

pantallonár-i m. sh. -ë, -ët; rrobaqepës pantallonash.

bulécë-a f. sh. -a, -at; shami e mëndafshtë që mbante nusja e re.

shóllë-a f. sh. -a, -at; opingë me xhufka pa lidhëza.

gjilmítër-a f. sh. -a, -at; lidhëza këpucësh ose çorapësh.

Leksik i mbledhur në krahinën e Durrësit.

njíl/ë-a zol. f. sh. -a, -at; peshk me kurriz në të zi e bark të bardhë me pika dhe kokën si të ngjalës, skobuz.

spálcë-a zol. f. sh. -a, -at; peshk i gjerë që ka kokën si të peshkut korb, me kurriz të përhimët dhe bark të bardhë, kocë.

kovác-i m.; peshk *kovaç* zool. peshk me trup të zi dhe i gjerë.

lojbë-a f. sh. -a, -at; peshk me ngjyrë të murme dhe me kokë të gjerë.

vópë-a zol. f. sh. -a, -at; peshk me ngjyrë kënaqe me pika të bardha të rralla, i gjatë deri 10 cm.

lejlék-u. peshk *lejlek* zool. peshk me trup dhe turi të gjatë, peshk gjilpërë.

ushójzë-a zool. f. sh. -a, -at; peshk me trup të gjerë në formë gjuhe dhe me lëkurë të fortë, gjuhëzë.

rrájë-a zol. f. sh. -a, -at; peshk me trup të gjerë, lëkurë të fortë, që e ka kokën si të breshkës.

karkaléc-a zol. m. sh. -a, -at; peshk që i ngjet karkalecit, me luspa rra-thë-rrathë në ngjyrë të kuqe.

zog-u *m. sh.* zogj-të; zog *kacalyti*, zol. zog mesatar i murmë me një kaçul mbi krye, dervishkëz.

skërpíshë-a zol. *f. sh.* -a, -at; mëllënjë.

brak-u *m. sh.* -ë, -ët; qen gjuetie për shpendë me trup të madh, i bardhë me njolla të zeza ose kafe, veshmadh e qimeshkurtër.

kulltínë-a *f. sh.* -a, -at; mbulesë prej leshi që i hidhet kalit përsipër, mbi të cilën vendoset shala.

kullásh-i *m. sh.* -ë, -ët; kalë laraman dyngjyrësh.

lul-i *m. sh.* -ë, -ët; ká lara-lara me pulla të bardha.

shytëlárë-a *f. sh.* -a, -at; lopë shytë lara-lara.

zíg-u *m. sh.* -ë, -ët; ka që ka hundën dhe këmbët të zeza.

lulishtár-i *m. sh.* -ë, -ët; punëtori që mirëmban lulishten. *fem.* **lulish-táre-ja**

